



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 29.06.2021

Nr: 97

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 56, PARAQITUR
NË KQZ NË DATËN 28.06.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.06.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Koalicioni “ABEOK”

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 56, datë 28.06.2021 të subjektit ankues Koalicioni “ABEOK” me objekt “Pavlefshmëri e vendimeve nga nr. 406 deri 417 datë 23.06.2021 të marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sepse mosmarrja e vendimit për votimin jashtë shtetit cenon përlllogaritjen dhe shpërndarjen e mandateve”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130, dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e palëve në seancë,



VËREN:

1. Subjekti ankues Koalicioni “ABEOK”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 56 regj., datë 28.06.2021. Në mbledhjen e datës 29.06.2021, ora 12:30, pas relativitetit të z. Koli Bele dhe diskutimit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 56 nuk i plotëson elementët e parashikuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor.
2. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja “b” parashikon se *KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitimin e ankuesit*. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës që ngre një pretendim, e cila kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
Duke qenë se objekt kundërshtimi janë vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021”, subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimet të cilat ai kundërshton. KAS konstaton se as në kërkesën ankimore, as në seancën paraprahe të zhvilluar nga ky Komision, subjekti ankues nuk ngriti ndonjë pretendim për fitimin e votave dhe ndarjen e mandateve, që janë objekt i vendimeve të KSHZ-së. Subjekti ankues nuk legjitimohet ti kundërshtojë këto vendime vetëm për faktin se është subjekt zgjedhor, pa provuar se ato prekin interesa të tij të ligjshëm, që është një nga kushtet themelore të legjitimitimit aktiv të palës që inicion një proces administrativ të shqyrtimit të një ankimi.
3. U konstatua gjithashtu se kërkesa ankimore kishte mangësi thelbësore të formës dhe përmbajtjes, ku mungonte referimi të vendimet që ankimohen, përshkrimi i shkeljes së pretenduar, përshkrimi i fakteve dhe argumenteve si dhe i provave mbi të cilat ankuesi bazon pretendimin e tij. Të gjitha këto janë elementë të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore të parashikuara shprehimisht në nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Gjatë seancës paraprahe, subjekti ankues ngriti pretendimin se arsyeja e mungesës së këtyre elementëve erdhi si pasojë e mos njohjes prej tij me vendimet objekt ankimi. Nga relativiteti i administratës së KQZ-së dhe verifikimi i kryer në vend, u konstatua se vendimet objekt ankimi janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, ku mund të aksesohen lirisht nga i gjithë publiku, prandaj ky pretendim i ankuesit nuk qëndron.

4. Për sa i përket mosmarrjes së vendimit për votimin nga jashtë vendit, KAS konstaton se kjo kërkesë përbën “gjë të gjykuar”, duke qenë se ky Komision është shprehur tashmë lidhur me të, në vendimin nr. 96, datë 17.06.2021, ku ndër të tjera ka theksuar se kompetenca për të marrë vendim lidhur me rregullat dhe procedurat përkatëse, i takon Komisionit Rregullator, bazuar në nenin 20, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se: *“Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për (...) rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin”*.

Në këtë rast, referuar nenit 145, pika 2 të Kodit, *subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja*.

Pra, KAS nuk është organi kompetent për të shqyrtuar kërkesat për mosmarrjen e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 21, 126 dhe 130, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenet 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronja “b” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 56, datë 28.06.2021 të paraqitur nga Koalicioni “ABEOK”;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Koli BELE - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

